

SYLLABUS – Hulumtimi në edukimin nga Kimia

| Të dhëna bazike të lëndës | | | |
|--|--|------------------|-----------------|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Edukimit Master i Mësimdhënies në Kimi | | |
| Titulli i lëndës: | Hulumtimi në edukimin nga Kimia | | |
| Niveli: | Master | | |
| Statusi lëndës: | Zgjedhore | | |
| Viti i studimeve: | Viti i parë, Sem. II | | |
| Numri i orëve në javë: | 2+1 (3 orë) | | |
| Vlera në kredi – ECTS: | 5 ECTS | | |
| Koha / lokacioni: | E enjte 14:00 – 15:30, P2 | | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Dr. Fatlume Berisha | | |
| Detajat kontaktuese: | fatlume.berisha@uni-pr.edu ; | | |
| Përshkrimi i lëndës | Fokus kryesor i këtij kursi është të shqyrtojë hulumtimet aktuale në edukimin nga kimia dhe të diskutojë çështjet që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënit e kimsë. Nga kjo bazë, studentët do të identifikojnë metodat e hulumtimeve në edukimin nga kimia, do të analizojnë rezultatet e hulumtimeve, formulojnë pyetje kërkimore dhe zhvillojnë planin e tyre të hulumtimit dhe shqyrtojnë literaturën përkatëse. Nëpërmjet shqyrtimit të literaturës dhe hulumtimeve individuale dhe në bashkëpunim nga fusha e edukimit nga kimia do të shqyrtohen lidhjet mes hulumtimeve dhe praktikave mësimore për përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit të kimsë. | | |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i kursit është aftësimi i studentëve për të lexuar në mënyrë ‘kritike’ dhe për të analizuar studimet në fushën e edukimit nga kimia Planifikimi hapave të një hulumtimit. dhe shqyrtimi i thellë i literaturës do të jetë pjesë e rëndësishme e kursit, që synon t’i bëjë studentët të shfrytëzojnë reflektimet për hulumtimet shkencore gjatë planifikimeve të aktiviteteve në orët e kimsë. | | |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Në përfundim të kursit studentët do të: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikojnë, përkufizojnë problemet e hulumtimit në fushën e edukimit nga kimia • analizojnë hulumtimet në fushën e edukimit nga kimia duke përfshirë shqyrtimin e literaturës, metodat e hulumtimeve dhe analizën dhe interpretimin e rezultateve; • planifikojnë hapat e hulumtimit varësisht nga metoda e hulumtimit; • analizojnë në mënyrë kritike studime të ndryshme për të identifikuar anët e forta dhe mangësitë konceptuale dhe metodologjike; • zhvillojë një projekt për një studim kërkimor në fushën e edukimit nga kimia | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |

| | | | |
|--|---|----|----------------|
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | - | - | - |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 10 | 10 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume, seminare | 3 | 2 | 6 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 10 | 20 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 10 | 20 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | | | |
| Projektet, prezentimet ,etj | 3 | 2 | 6 |
| Totali | | | 137 orë |

137: 25 ≈ 5 ECTS.

| Metodologjia e mësimdhënies: | <p>Në këtë kurs do të zbatohen metodat ndërvepruese të mësimdhënies, duke i angazhuar studentët në diskutime për çështje të rëndësishme, duke u bërë të mundur që të reflektojnë mbi përvojën e tyre dhe duke i lejuar ata të shprehin idetë e tyre, besimet, dhe përvojat rreth temave të caktuara në kontekst të përmirësimit të praktikës së tyre profesionale.</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|-------------------------------------|---|---------------------------|-----|-----------------------|-----|--------------------|-----|--------------|-------------|--|------------------|-------------|--|----------|----|--|---------|---|--|---------|---|--|---------|---|--|---------|---|
| Metodat e vlerësimit: | <p>Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete: Vlerësimi në këtë kurs zbaton qasjen e vlerësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi në këtë kurs synon jo vetëm të verifikojë aftësitë dhe arritjet e studentit të caktuar por edhe bashkëpunimin e tyre brenda grupit dhe ngritjen e përgjegjësisë për të kontribuar në zhvillimin e kolegëve brenda grupit.</p> <p>Nota përfundimtare caktohet sipas vlerësimit të mëposhtëm:</p> <table> <tr> <td>Pjesëmarrje dhe diskutim.</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtare</td> <td>30%</td> </tr> <tr> <td>Projekti hulumtues</td> <td>60%</td> </tr> <tr> <td>TOTAL</td> <td>100%</td> </tr> </table> <p>Skema e vlerësimit</p> <table> <thead> <tr> <th></th> <th>Pikët (%)</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>94 - 100</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td></td> <td>84 - 93</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td></td> <td>73 - 83</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td></td> <td>61 - 72</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td></td> <td>50 - 60</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p>Të gjitha obligimet të dërgohen përmes emailit. Dokumentet të ruhen si në shembujt më poshtë: Projekti Hulumtues. Filan Fisteku, HEK</p> <p>Referenca dhe stili i shkrimit Studentët inkurajohen të përdorin stilin akademik gjatë hartimit të detyrave të kursit dhe në rast të shfrytëzimit të burimeve të tjera duhet t'i binden rregullave të APA-s.</p> | Pjesëmarrje dhe diskutim. | 10% | Provimi përfundimtare | 30% | Projekti hulumtues | 60% | TOTAL | 100% | | Pikët (%) | Nota | | 94 - 100 | 10 | | 84 - 93 | 9 | | 73 - 83 | 8 | | 61 - 72 | 7 | | 50 - 60 | 6 |
| Pjesëmarrje dhe diskutim. | 10% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Provimi përfundimtare | 30% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Projekti hulumtues | 60% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| TOTAL | 100% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Pikët (%) | Nota | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 94 - 100 | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 84 - 93 | 9 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 73 - 83 | 8 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 61 - 72 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 50 - 60 | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| Literatura | |
|----------------------------|--|
| Literatura bazë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Vula. E. (2016). Hulumtimi në veprim. Universiteti i Prishtinës. 2. Vula.E (2015) Hulumtimi në veprim (udhëzime praktike): BEP ks.org/wp-content/uploads/2015/03/BEP; 3. Koshy, V. (2010). Action Research for improving Educational Practice. Sage Publications Ltd. 4. Stringer, E, (2014). Action Research in Education. Pearson Education, Inc |
| Literatura shitesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Mcniff. J & Whitehead, J.(2009). Doing and Writing Action Research. London Sage; 2. Hopkins, D. (1985). A teacher Guide to classroom research, Open University press, England; 3. Artikuj të zgjedhur shkencor |

Plani i dizajnuar i mësimi:

| Java | Ligerata që do të zhvillohet | Aktiviteti në klasë dhe shtëpi drejt realizimit të një hulumtimi |
|-----------------------------|--|---|
| Java e parë: | Paraqitja e kursit – detyrat | |
| Java e dytë: | Përmbledhje për hulumtimet në arsim. Kap.1 | Shqyrtim i përbashkët për temat e mundshme të hulumtimeve |
| Java e tretë: | Hulumtimi në veprim. Mësimdhënësit hulumtues Kap.2 | Vazhdim i diskutimit të temave për hulumtime |
| Java e katërt: | Shqyrtimi dhe analiza e literaturës dhe burimeve tjera .Kap.4 | Shyrtimi kritik i artikujve të lexuar (Fokusi në temat hulumtuese) |
| Java e pestë: | Zhvillimi i planit të hulumtitimit në veprim. Ciklet e hulumtitimit. Kap.3 | Identifikimi i problemit të hulumtitimit. |
| Java e gjashtë: | Planifikimi i veprimit – llojet e dizajneve të HV. Kap.5 | Kap. 5. Planifikimi i draftit të parë të dizajnit të hulumtitimit |
| Java e shtatë: | Mbledhja e të dhënave sasiore. Hartimi i planit për mbledhjen e të dhënave; teknikat dhe metodat për mbledhjen e të dhënave. Kap.6 | Shqyrtim i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave |
| Java e tetë: | Mbledhja e të dhënave cilësore. Hartimi i planit për mbledhjen e të dhënave; teknikat dhe metodat për mbledhjen e të dhënave Kap.6 | Mbledhja e të dhënave në klasat hulumtuese |
| Java e nëntë: | Analiza dhe interpretimi i të dhënave sasiore.Kap.7 | Mbledhja e të dhënave - vazhdim |
| Java e dhjetë: | Analiza dhe interpretimi i të dhënave cilësore.Kap.7 | Mbledhja e të dhënave dhe fillimi i analizës |
| Java e njëmbëdhjetë: | Diskutimi dhe plani i veprimeve Kap.8 | Analiza e të dhënave vazhdon dhe diskutohen me ‘miqt kritik’ planet e veprimeve |
| Java e dymbëdhjetë: | Shkrimi i raporteve të hulumtimeve. Kap.9 | Finalizimi i shkrimit të raportve |
| Java e trembëdhjetë: | Prezantimi i projekteve hulumtuese | Reflektime |
| Java e | Prezantimi i projekteve hulumtuese | Reflektime |

| | | |
|------------------------------|---------------------|--|
| katërmbëdhjetë: | | |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Provim përfundimtar | |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Përcjellë ligjëratat dhe të kryejnë të gjitha detyrat e përshkruar në syllabus. Të gjitha punët, por edhe pjesëmarrja në ligjërata janë pjesë e vlerësimit përfundimtar.
- Jetë i/e lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.
- Lexoj literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë, të përgatitet për të gjitha aktivitetet tjera.
- Përgatitë dhe dorëzon të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonesë do të ndëshkohet me pikë të humbura.
- Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara (shih shembuj në Doracakun për shkrimin e tezës së Masterit).
- Në provimin përfundimtar kanë të drejt të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjërata dhe ushtrime dhe që kanë kryer detyrat gjatë kursit.
- Studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar më së shumti tri herë (Neni 115 i Statutit të UP-së).
- Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë.
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.
- Nuk lejohet KOPJIMI dhe cilado formë tjetër e mashtrimit gjatë provimeve.